

Për shkollë pa diskriminim!



- Udhezues për punë në parandalimin dhe
tejkalimin e diskriminimit për të rinjtë dhe nxënësit -



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education





Për shkollë pa diskriminim!

- Udhezues për punë në parandalimin dhe tejkalimin e diskriminimit për të rinjtë dhe nxënësit -

Podgoricë, 2019.

PËR SHKOLLË PA DISKRIMINIM!

- Udhezues për punë në parandalimin dhe tejkalimin e diskriminimit për të rinjtë dhe nxënësit -

Botues:

Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ)

Redaktore:

Dalliborka Ulareviq

Autorët:

Petar Gjukanoviq

Vasko Raiçeviq

Përktheu:

Liridon Vulaj



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

Publikimi është pjesë e projektit "360° Rrethi i plotë për të drejtat e njeriut" të cilin e zbaton Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ) në partneritet me OJQ-në Kompanija Alternative Teatrale (ATAK) nga Podgorica, Shtëpinë për të Drejtat e Njeriut nga Zagrebi dhe Festivalin Ndërkombëtarë për Filma Dokumentar (BELDOCS) nga Beogradi, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Institucionin Mbrojtësin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Mali i Zi, financuar nga Bashkimi Evropian.



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e QEQ-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtarë i Bashkimit Evropian.

Hyrje



Udhezuesi për punë në parandalimin dhe tejkalimin e diskriminimit për të rinjtë dhe nxënësit "Për shkollë pa diskriminim!" u krijua në kuadër të projektit *360° Rrethi i plotë për të drejtat e njeriut*, të cilin me përkrahjen e Bashkimit Evropian e realizon Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ), në partneritet me OJQ-në Kompanija Alternative Teatrale (ATAK) nga Podgorica, Shtëpinë për të Drejtat e Njeriut nga Zagrebi dhe Festivalin Ndërkombëtar të filmave dokumentar (BELDOCS) nga Beogradi, e në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Institucionin Mbrojtësin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Mali i Zi.

Një nga qellimet specifike të projektit është promovimi i konceptit të arsimit pa diskriminim në sistemin formal edukativo-arsimor dhe zhvillimin e antidiskriminimit dhe kulturës të drejtave të njeriut ndërmjet të rinjëve. Për këtë, ky udhezues u dedikohet të rinjëve dhe nxënësve që t'ju ndihmojë në njohjen, parandalimin dhe procesimin e rastëve të diskriminimit, shkeljeve të tjera të drejtave të njeriut, dhunës mbrenda institucioneve arsimore dhe para institucioneve jashtë sistemit arsimorë.

Në udhezues janë të sqaruara hollësisht konceptet e diskriminimit dhe manifestimet e ndryshme të tij, rolet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në procesin edukativo-arsimor, dhe është dhënë një pasqyrë e shkurtër e kuadrit institucional i cili mbron nga diskriminimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut, me përshkrimin e procedurës të përpunimit të rastëve mbrenda dhe jashtë sistemit shkollorë.

Qellimi përfundimtarë i udhezuesit "Për shkollë pa diskriminim!" është që si mjet ndihmës t'ju ofrojë të rinjëve përkrahje që të marrin pjesë në mënyrë aktive në mbrojtjen e të drejtave të veta, parandalimin e diskriminimit dhe shkeljen e të drejtave të tjerëve, si dhe në avokimin dhe promovimin e kultures së drejtave të njeriut në mjedisin shkollorë dhe lokal.

Çka është diskriminimi dhe si ta njohim?



Diskriminimi është një nga format më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Të drejtat e njeriut na përkasin që nga lindja, me vetë faktin se jemi qenie njerëzore. Janë univerzale dhe u përkasin të gjithë njerëzve pa dallim, janë të patjetërsueshme sepse nuk janë dhurata ose merita, nuk mund të shiten ose të merren dhe janë të pandashme, çka do të thotë se të gjitha të drejtat e njeriut janë po aq të rëndësishme. Për shembull, të drejtat e njeriut janë e drejta e jetes, liria e lëvizjes, liria e shprehjes, etj.

Të drejtat e njeriut na mundësojnë jetë të dinjitetshme në shoqëri dhe mundësi që të zhvillohemi si personalitete ndaj nevojave, dëshirave dhe aspiratave dhe të bëhemi anëtarë të barabartë të komunitetit në të cilin jetojmë.

Rrespektimi i të drejtave të njeriut bazohet në faktin se çdo person është po aq i vlefshëm, se çdo kush mund të levizë lirshëm, të shpreh mendimin e vet, dhe në bazë të barabartë të marrë pjesë në jetën shoqërore, të edukohet, të zhvillohet në bazë të aftësive të veta, të jetë i lirë nga tortura dhe sjellja çnjerëzore dhe diskriminimi. Të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit krijojnë mundësi që secili prej nesh të zhvillohet dhe të arrijë maksimumin e potencialeve të veta për të mirën e vetvetit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Diskriminimi kufizon njerëzit në zhvillimin e kapacitetëve të veta, në vetëafirmim dhe kontribon në ndjenjën e poshtërimin, pafuqisë dhe lëndimit. **Diskriminimi** është sjellje e dallimit dhe sjellje e trajtimit të pabarabartë ndaj njeriut dhe grupit të njerëzve për shkak të veçorive individuale që i bëjnë të ndryshëm ndaj të tjerëve. Veçoritë personale mund të jenë ngjyra e lëkures, gjini, orientimi seksual, përkatësia etnike apo religjioni, statusi material, faktit se dikush është i pasur e dikush i varfër, etj. Diskriminimi paraqitet kur veprohet ndryshe ndaj njerëzve vetëm në bazë të veçorive personale ose përkatësisë të ndonjë grupi, ose kur përjashtohen nga bashkësia dhe shoqëria (grupit të moshatarëve, shkolla), dhe kur favorizohen ose vendosen në pozicion inferior.

Dallimet ndërmjet njerëzve janë të pashmangshme dhe paraqesin fakt natyror. Arritja e suksesit në shkollë është pasojë e dallimeve tona në talente, kapacitete, dije dhe aftësi, dhe kjo është normale. Diskriminimi ndodhë kur veçoritë tona personale, si ngjyra e lëkures, invaliditeti ose një veçori tjetër bëhen elemente kryesore vendimtare për akses në arsim dhe për arritje tona arsimore, para dijes tonë, meritave dhe aftësive. Dallimi i njerëzve bëhet problematik dhe diskriminues atëherë kur pozita jonë dhe mundësitë në shoqëri kushtëzohen me veçoritë tona. Nuk është diskriminim nëse të gjithë nuk marrim nota të njëjtë, sepse çdonjëri prej nesh ka nivel dijenje të ndryshëm dhe ka përkushtuar kohë dhe përpjekje të ndryshe që të mësojë, pra në përputhshmëri me këtë dhe kriterëve objektive marrim nota të ndryshme për dije dhe aftësi tona.

Diskriminimi ndodhë atëherë kur njerëzve të caktuar i veshtirësohet apo shkelet arritja e të drejtave dhe lirive të njeriut vetëm pse janë me ngjyrë të ndryshme, flasin gjuhë të ndryshme, kanë emrin ose mbiemrin e ndryshëm, kanë orjentim seksual të ndryshëm, ose janë materijalisht të varfër. Nëse një djali apo vajze i veshtirësohet rregjistrimi në shkollë dhe kërkohen kushte dhe dokumente të cilat nuk u kërkohen fëmive tjerë, ose u jepen nota më të ulëta për kualitet të njëjtë të dijes, ose ofendohen dhe thirren me emra fytes, përulen dhe përbufzen nga nxënësit dhe mësimsdhënësit tjerë, vetëm pse janë Rom, atëherë mund të flasim për diskriminim. Në thelb **diskriminimi është trajtim i ndryshëm i njerëzve në situatë të njëjta ose të ngjajshme vetëm për shkak të veçorive personale**. Gjithashtu, diskriminimi ndodhë kur personat të cilët gjenden në pozitë të ndryshme trajtohen në mënyrë të njëjtë (barabartë). Për shembull, personat me invaliditet gjenden në pozitë të pabarabartë në krahasim me personat të cilët nuk kanë invaliditet në procesin arsimorë. Programi dhe metoda e punës të cilat zbatohen në mësimsdhënie duhet të jenë të përshtatura aftësive idnividuale të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore dhe të orientuara në zhvillimin maksimal të aftësive të cilat i kanë, dhe kjo paraqet mënyrën e vetme që të shmangët diskriminimi i tyre. Për këtë është e rëndësishme që fëmijet me invaliditet të kyçen në sistemin edukativo-arsimorë dhe gjatë shkollimit t'ju mundësohen shërbime adekvate përkrahjeje (asistimi në mësim, literatura në formë të përshtatshme), plani dhe programi arsimor në përputhje me mundësitë, aftësitë dhe interesimin e tyre, në mënyrë që të mundën të kryejnë obligimet e tyre të përditshme në shkollë, të mësojnë dhe zhvillohen ashtu si moshatarët e tyre pa invaliditet. Në anën tjetër, përfshirja e të rinjëve me nevoja të posaçme arsimore është e dobishme edhe për nxënësit tjerë dhe shoqërinë, sepse kontribon në socializimin dhe edukimin për jetë në shoqëri, tolerancë dhe solidaritet, pra formon një shoqëri ku të gjithë anëtarët e saj janë të barabartë dhe kanë mundësinë të japin kontributin për zhvillim dhe afirmim të asaj shoqëri.

Bazat e diskriminimit – veçoritë personale

Diskriminimi bazohet në dallim dhe trajtim të pabarabartë për shkak të veçorive personale.


Nëse mësimitdhënësi jep notën më të mirë nxënësit për arsye simpatie, edhe pse në krahasim me nxënësit tjerë nuk ka treguar më shumë dije, atëherë bëhet fjalë për joobjektivitet dhe shkelje të rregullave profesionale dhe të procesit të vlerësimit, i cili lidhet me profesionin dhe funksionin e mësimitdhënësit, por nuk është diskriminim. Për diskriminim do të mund të flasim në rast se mësimitdhënësi nxënësit i cili është Romë i ka dhënë notë më të ulët në krahasim me nxënësin i cili nuk i përket popullatës Romë, vetëm për arsye se nuk e simpatizon për shkak të përkatësisë etnike të tij ose ngjyres, edhe pse të dy e kanë plotësuar njëjtë testin e dijes. Diskriminim është kur mësimitdhënësi nxënësit Romë i thotë: "Shihet se je Romë, shiko si e ke fletoren e parregullt!", sepse me këtë promovon dhe forcon stereotipet dhe paragjykimet ndaj Romëve si të parregullt dhe pakujdesshëm. Ose, kur mësimitdhënësi tolerojnë mungesën e nxënësve Romë nga shkolla, duke u bazuar në paragjykim e rrezikshëm dhe të gabueshëm se Romët nuk janë të interesuar për mësim, ata atëherë bëjnë diskriminim. Pra, mund të ekzistojnë plot arsye pse nxënës Romë nuk vijnë në mësim dhe detyra e mësimitdhënësit dhe shkollës është që ato arsye të shqyrtojë dhe të provojnë të rregullojë problemin, sepse çdo fëmijë ka të drejtë dhe nevojë të edukohet, vetëm disa fëmijë mund të kenë pengesa të caktuara për të cilat ata kanë nevojë për mbështetje për t'i zotëruar dhe për të ndjekur rregullisht mësimin.

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit përkrahur listën e veçorive të cilat nuk guxojnë të jenë bazë për dallime kur është në pyetje qasja e njëjtë e të drejtave, siç është edhe qasja e drejtës për arsimi dhe zhvillim në arritjet arsimore. Kjo listë është listë e veçorive personale ose bazë e mbrojtur për dallim që nuk duhet të jenë shkak për diskriminim. Lista përmban gjininë, përkatësinë etnike, besimin, invaliditetin, orientimin seksual, gjëndjen materijale, statusin shoqërorë, gjëndjen shëndetësore, statusin e punës, gjuhën, etj.

Veçoritë personale të cilat janë bazë e diskriminimit zakonisht ndahen në ato të arritura dhe të lindura. Të lindura janë, për shembull, ngjyra e lëkures dhe gjinia. Veçoritë e arritura janë ato veçori të cilat i fitojmë ose arrijmë gjatë jetës, të cilat mund të ndërrohen, nganjëherë lehtë, nganjëherë më vështirë, siç është statusi material. Të lindura ose të arritura, veçoritë personale nuk guxojnë të jenë bazë për trajtim ose sjellje të jobarabartë. Fakti që jemi me ngjyrë të ndryshme ose përkatësi etnike të ndryshme nuk guxon të jetë bazë me të cilën dikush prej nesh do të ketë përfitime, ose të jetë i kufizuar në arritjen e qasjes në arsim dhe të drejtave tjera në procesin arsimorë.

Nganjëherë si bazë e diskriminimit lajmërohet dhe supozohet veçorija personale. Dikush që shoqërohet me njerëzit LGBT mund të jetë i diskriminuar, sepse supozohet se edhe ai është anëtar i këtij grupi, edhe pse ndoshta ai nuk është.

Diskriminimi është i ndaluar, pavarësisht a është trajtimi i ndryshëm në bazë të veçorive personale të supozuara ose reale.



Çka e shkakton diskriminimin?

Në thelbin e trajtimit diskriminues shpesh janë stereotipet dhe paragjykimet ose qëndrimet e përgjithshme të cilat i formojmë në informacione të paplota, shpesh të pasakta, e të cilat janë të percjellura me ndjenja të forta, siç është friga, mospëlqimi, e nganjëherë edhe urrejtja. Qëndrimet janë mendimet dhe besimet të cilat na bëjnë që të sillemi në mënyrë të caktuar.

Stereotipi nënkupton gjeneralizimin e tepërt ndaj një grupi njerëzish dhe presupozimi se të gjithë anëtarët e atij grupi ndajnë karakteristika të njëjta. Shpesh është thënë se stereotipet janë produkt i mënyres së menduarit tek njerëzit, ku egziston tendenca që të thjeshtëzohen gjërat, pra nuk është e domosdoshme të kenë domethënie negative. Stereotip i shpeshtë tipik është se italianet janë këngëtarë të shkëlqyeshëm, ose se suedezët janë të ftoftë dhe të përmbajtur. Për shembull, ekzistojnë disa mite dhe stereotipe të cilat janë të theksuara ndaj homoseksualëve në të cilat bazohet homofobia, siç është qëndrimi se homoseksualiteti kalohet me mësim, ashtu që mësuesi homoseksual mund të ndikojë që edhe vetë nxënësit të bëhen homoseksual, homoseksualiteti është sëmundje, perversion dhe imoralitet dhe në bazë të kësaj arsyetohet dhuna ndaj LGBT grupacionit, angazhimi që të ndalohet profesioni edukativo-arsimorë për homoseksualët, të ndalohet mësimi për homoseksualitet në shkollë, etj.

Stereotipet janë edhe kur thohet se personat homoseksual janë vetëm meshkujt të feminizuar dhe femra me karakteristika mashkullore, edhe pse lezbejke ka edhe ndërmjet balerinave dhe manëkenëve, si dhe gej ndërmjet futbollistave dhe puntorëve fizik. Çdo stereotip ndaj homoseksualëve, për shembull, bazohet në sjelljen ekzistuese, por atëherë kalohet dhe zbatohet në të gjithë anëtarët e grupit ose popullatës dhe shërben si argument për homofobi.

Stereotipet nuk janë vetëm negative, p.sh. për homoseksual shpesh thuhet se kanë stil dhe se janë kreator të shkelqyeshëm të modes, ose se meshkujt të prirur për art janë gej. Megjithatë, edhe stereotipi pozitiv është i rrezikshëm, sepse plotësisht e bjen grupin në një veçori pozitive dhe thjeshtëzimi demanton ekzistencën e ndryshimeve mbrenda grupit.

Paragjykimet janë qëndrime të percjellura me emocione të forta të cilat mbështeten në informacione të pasakta dhe janë shkak i sjelljeve të shumta negative, në mes të cilave është edhe diskriminimi. Përkatesisht, paragjykimi është pa bazë, mendim negativ i gabuar, qëndrim i cili bazohet në eksperienc personale. Paragjykimet zakonisht percjellin emocione të forta negative siç janë urrejtja dhe dëshira të përulet ose gjobitet dikush.

Përgjithësimet të cilat i mbështasin stereotipet dhe paragjykimet janë të gabueshme, sepse kur flasim për njerëzit ekzistojnë nuansa të panumërta në dallimet tona të cilat na bëjnë të veçantë dhe të ndryshëm, bile edhe mbrenda grupit të ngushta të cilave u përkasim. Qëndrimet stereotipe dhe paragjykuese janë, për shembull, edhe qëndrimet se Romët janë dembel, të papaster dhe të prirë për hajni, të paiteresuar për arsim. Të gjithë kemi paragjykimet dhe stereotipe, por është me rëndësi që ti vetëdijësojmë në mënyrë që të hapemi ndaj njerëzve tjerë, që të kemi më shumë mirëkuptim dhe ti pranojmë të barabartë si vetvetin.

Paragjykimet lehtë kalojnë në diskriminim dhe ndikojnë që të sillemi ndaj tjerëve si ndaj njerëzve të ndryshëm nga vetja ashtu që largohemi nga ta, i izolojmë, i kufizojmë në ushtrimin

e të drejtave dhe lirive, u ndalojmë të ndajnë hapësirën me ne, të arsimohen, punësohen ose punojnë, bile edhe veprimet dhunshëm (akte dhune individuale, dhunë e organizuar, planifikuar, aktivitetet sistematike siç ishte tmerri i hollokaustit). Diskriminimi percaktohet edhe si fenomen, kur individi ose grupacioni i njerëzve shpallet më pak i vlefshëm në krahasim me individet ose grupacionet tjera, në bazë të kësaj "legjitimisht" u shfuqizohen ose kufizohen të drejtat dhe liritë, përkatësisht vuhën në pozitë të pabarabartë në qasjen dhe ushtrimin e të drejtave. Nacizmi si ideologji ka legjitimuar diskriminimin, i cili kaloi në vrasjen e miliona njerëzve, kryesisht Hebrej, Rom dhe të tjerë, të cilët janë paraqitur si rrezik për "pastertinë" dhe "perfeksionin" e races ariane.

Diskriminimi shpesh është shkak i stereotipëve dhe paragjykimëve. Për këtë disa thonë se *diskriminimi është paragjykim në veprim*. Nëse ekziston mendimi negativ për një grup, ajo është e përcjellur me emocione negative dhe akcione të cilat janë në përputhshmëri me ato mendime dhe emocione. Edhe pse flitet për pasurinë e diversitetit, shpesh ndodhë që diversiteti të perceptohet si kërcënim, përkatësisht që njerëzit të cilët për nga veçoritë e tyre dallohen nga shumica perceptohet si e keqe, më pak e vlefshme, dhe ashtu bëhen viktimë e moskuptimit, largimit dhe armiqësisë. Për këtë lufta kundra diskriminimit në vehte përmban edhe luftën kundra stereotipëve dhe paragjykimëve.

Stereotipet dhe paragjykimet të cilat i zhvillojmë si individ në kontekstin më të gjërë shoqërorë shkaktojnë paraqitjen e: **ksenofobisë** (friga, përkatësisht urrejtja ndaj të huajve), **homofobisë** (friga, përkatësisht urrejtja ndaj personave LGBT), **islamofobisë** (friga dhe urrejtja ndaj muslimanëve dhe islamit), **rasizmit** (sjelljen dhe mohimin e personave të caktuar për shkak të ngjyrës së tyre të lëkurës), **gerontofobisë** (fanatizmin ndaj personave të vjetër), **nacionalizmit** (bindja e vlerës më të lartë të kombit), **seksizmit** (bindja e vlerës më të lartë të një gjinije) etj. Këto paraqitje shkaktojnë diskriminimin individual, sistematik dhe institucional.





Diskriminimi dhe dhuna

Diskriminimi lehtë kalon në dhunë, verbale apo fizike, dhe shumë prej nesh heshtin dhe lëjojnë që të ndodhë diskriminimi. Te tri këto forma sjelljesh janë të papranueshme. Dhuna nuk është çdoherë diskriminim, nëse dy djem rrahen ndërmjet vete për ndonjë mospajtim atëherë kjo është dhunë e cila është e keqe dhe dëmshme, por nuk është diskriminim. Nëse një grup djemësh e rrahin dhe gjuejn shokun e vet Rom para shkollet ndërsa të tjerët këndojnë "Vraje magjypin!" atëherë ka të bëjë me dhunën e cila është shkak i diskriminimit.

Dhuna dhe diskriminimi janë sjellje të palëjueshme të cilat kanë pasoja afatgjate për viktimen, por edhe për shoqërinë në përgjithësi, nëse në këto ngjarje nuk reagohet ose heshtet. Viktimat e dhunës dhe diskriminimit ndjehen të poshtëruar, shpesh atëherë vendosin të largohen nga shkolla, mos të shoqërohen me tjerët sepse ndjehen të turpëruar, ndjehen të larguar dhe të trishtuar, etj. Dikush për shkak të diskriminimit dhe pasojave që diskriminimi i ka lën në të, në vehte do të mbyllë potencialin e madh të cilin ka mundur ta ofrojë si shok i mire, kolegë, shkencëtar i talentuar, etj.

Dhuna dhe diskriminimi i kthehen shoqërisë si bumerang në formën e **dhunës së kundërt**. Domethënë, diskriminimi lehtë mund të drejtohet në grupet tjera në shoqëri dhe kështu shoqërisë në përgjithësi ti sjellin dëme të mëdha nëse normalizohet dhe bëhet model i tolerueshem. Miratimi i heshtur i sjelljes diskriminuese ndaj kujdo është identike sikur ne të diskriminojmë. Nëse shihni dhe vëreni diskriminimin mos heshtni- reagoni, ndaloni dhunuesin dhe diskriminuesin që mos të shkaktojnë dhimbje dhe vuajtje viktimës, paraqitni rastet në të cilat dëshmoni dhe në atë mënyrë parandaloni zgjerimin e sjelljeve të tilla.

Të gjithë duhet të jemi të barabartë, ndërsa **në luftë kundra diskriminimit secili prej nesh ka përgjegjësinë e vet** për atë se ne çfarë shoqërije do të jetojmë. Prandaj kushdo që ka perjetuar dhe dëshmuar diskriminimin ka obligim që ta paraqes dhe të kërkojë ndihmë. Nëse të gjithë veprojmë kështu kemi mundësinë të ndertojmë shoqërinë në të cilën askush prej nesh nuk do të jetë viktimë e dhunës ose diskriminimit, ne të cilën do të mbizotërojë toleranca dhe diversiteti do të pranohet dhe rrespektohet.

Me rëndësi është të dihet se asnjëri që ka raportuar diskriminimin ose ndonjë shkelje tjetër të njeriut për atë nuk guxohet të jetë i viktimizuar, gjegjësisht të vuajë pasoja negative. Nga kjo na mbron edhe Ligji për Ndalimin e Diskriminimit, që do duhej të na inkurajoj që aktivisht të reagojmë dhe raportojmë diskriminimin dhe në këtë mënyrë ta parandalojmë.

Siç e kemi cekur, diskriminimi nënkupton trajtim të pabarabartë apo të ndryshëm ndaj

Diskriminimi – një term, shumë persona

një personi apo grupi në bazë të veçorive tyre personale, e cila për pasojë ka pabarazinë në mundësi të ushtrimit të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe ligj.

Diskriminimi ndodhë në forma të ndryshme, aj nganjëherë vërehet dhe mund të identifikohet lehtë, por në realitet shpesh është shumë i fshehur dhe i vështirë për tu provuar. Më lehtë është të vërehet diskriminimi direkt, gjegjësisht i drejtëpërdrejt. **Diskriminimi i drejtëpërdrejt ose i direkt** do të thotë se është i qëllimshëm dhe se tendenca e shkelësit është diskriminimi i dukshëm. Nëse drejtori i shkollës merr vendim për ndalimin e pranisë së nxënësve Romë në orët e edukates fizike, me shpjegim se është e rrezikshme të lejohen në sallen e veshjes sepse janë të "zhytur", ose me arsyetim se do mund të vjedhin gjërat e nxënësve tjerë, atëherë bëhet fjalë për diskriminim direkt i cili bazohet në paragjykim të rrezikshëm se Romët janë të zhytur dhe se kanë tendencë për vjedhje. Para d i s a vitëve, në Mal të Zi, është raportuar rasti i diskriminimit direkt për shkak të vendimit me të cilin u ndalohet regjistrimi në shkollë nxënësve të cilët janë të infektuar me HIV virus, sepse prindërit e fëmijëve tjerë janë friguar për fëmijet e vet. Kjo sjellje dhe trajtim është, gjithashtu, shëmbull i diskriminimit direkt i cili është i bazuar në qendrimet e gabuara dhe të pabaza. Në këtë rast nuk ekziston asnjë arsye racionale që vajzes ti ndalohet qasja në arsim vetëm pse ka sëmundje kronike, sepse sëmundja me sukses mbahet nën kontroll duke ju falenderuar terapisë dhe nuk kalohet me kontakte sociale, ashtu që nuk ka rrezik për shëndetin e femijeve tjerë.

Sot, megjithatë, për arsye të vetëdijes më të avancuar për diskriminim por edhe sistemit më të zhvilluar për parandalimin të diskriminimit dhe gjobave, veprimëve të institucionëve e posaçerisht shoqërisë civile, këto raste nuk ndodhin aq shpesh dhe në mënyrë direkte, më i shpesht është diskriminimi indirekt apo tërthorë.

Diskriminimi indirekt është më vështirë për tu identifikuar dhe për këtë është më i rrezikshëm, sepse diskriminuesi ka dëshirë ta fsheh qëllimin. Shpesh, në literaturë, përmendet shëmbulli kur profesori vendos rregullin që nxënësit ti kryejnë detyrat e shtëpisë dhe ti dërgohen me post elektronike prej shtëpije, me çka në pozitë të vështirë i bjen ata të cilët nga shtëpija nuk kanë internet. Do të thotë, diskriminimi indirekt, fillon atëherë kur një rregull apo praktikë është vendosur në mënyrë që të marginalizojë një grup të caktuar. Për dallim nga diskriminimi direkt, në rastin e diskriminimit indirekt, ai i cili diskriminon nuk



deshiron që sjellja e tij diskriminuese të jetë e dukshme, në këtë mënyrë e kryen qellimin e tij të diskriminimit. Nganjëherë edhe ai i cili diskriminon nuk është i vetëdijshëm se po sjellet në mënyrë diskriminuese, sepse nuk e kupton çfarë është diskriminimi dhe çfarë pasojash shkakton. Diskriminim indirekt është edhe rasti i përshkruar më herët, kur në arsimim nxënësit me nëvoja të posaçme trajtohen në mënyrë të njëjtë sikurse nxënësit tjerë. Nëse në shkollë organizohet shfaqja dhe vendoset që të organizohet në katin më të naltë të objektit edhe pse kjo shfaqje do të mund të organizohej në një hapësirë tjetër, e cila është e përshtatshme për lëvizjen e nxënësve me invaliditet, sepse katet e naltë zakonisht nuk janë të përshtatshëm, atëherë do të mund të flasim për diskriminim. Me rëndësi është të dihet se reagimi në çdo moment duhet të ekzistojë që të eliminohet diskriminimi, edhe pse dikush ka diskriminuar me qellim, pa qellim ose pavetëdije nuk e liron nga faji për trajtim të tillë.

Me ligjin për ndalimin e diskriminimit janë të definuar edhe format e posaçme të diskriminimit në mesin në mes të cilëve janë edhe shqetësimi, shqetësimi seksual, segregacioni dhe gjuha e urrejtjes.

Shqetësimi është sjellja e drejtuar në shkeljen e dinjitetit të personit i cili është diskriminuar në disa baza dhe krijimin e ambijentit frikësues, armiqësorë dhe fyesë. Shembull i këtij lloji diskriminimi në arsim do të ishte kur grupi i nxënësve ngacmon, thërret shokun e vet nga klasa me emra ofendues për arsye të orientimit seksual real apo të supozuar të tij dhe me zë të lartë komenton se çdo „peder“ duhet të vritet. Ose, kur klasa përqesh suksesin e nxënësit vetëm për shkak të veçorive ose përkatësisë personale, përkatësisht kur nxënësin Rom shokët e klasës e përqeshin sepse nuk din çdoherë saktë ti përdorë rasat në komunikim, flet shumicën e gjuhës me akcent ose lexon ngadalë, e mësimdhënësi nuk reagon që të ndalojë ngacmimin.

Përqeshja e pamjes fizike, prejardhjes sociale, gjinisë, orientimit seksual ose ndonjë veçorije personale tjetër, si nga ana e nxënësve apo profesorave, gjithashtu, nënkupton shembuj të shqetësimit, pavarësisht a rrjedh nga nxënësi apo mësimdhënësi. Për shembull: profesori argëton klasen duke përqeshur pamjen fizike të nxënësve, e shoqet e saja e thrrasin të trashë dhe të marrë, apo kur mësimdhënësi flet shaka në llogari të një prej grupëve të pakicave. Shembull i ngjajshëm do të ishte ai kur profesori e imiton dhe përqesh ecjen, fjalimin dhe pamjen e nxënësit me pëngesa në zhvillim ose invaliditet para nxënësve tjerë në klasë.

Përveç shqetësimit verbal ekziston edhe shqetësimi ose ngacmimi me gjeste, siç është zgjatja e gjuhes, ose kur për shembull nxënësit mbyllin hundën sikur ka erë të pakëndshme kur kalojnë pranë shokëve të vet të klases të cilët janë Rom. Në literature përmenden edhe shembujt e shqetësimit me frikësimin e qenit udhëzues i cili i asiston nxënësit që ka problem me pamje, ose gjuajtjen e shkopit të bardhë, pështymjen, etj.

Shqetësimi seksual, gjithashtu, nënkupton një lloj të diskriminimit dhe paraqet një nga format më të rënda. I referohet fjalorit seksist me të cilin viktimës i drejtohen komente në llogari të pamjes së jashtme me aluzione të qarta seksuale, thirrje për marrëdhënie seksuale, etj. Seksizmi bëhet edhe me gjeste, për shembull, me shikim, duke dërguar puthje ose duke dërguar gjeste të cilat kanë konotacion seksualë, pickimin ose ramjen në prapnicë, ledhatimin në të cilën viktimat nuk ka pranuar, etj.

Ligji definon shqetësimin seksual si "çdo sjellje e pa dëshiruar verbale, joverbale ose sjellje seksuale fizike me të cilën dëshirohet të lëndohet dinjiteti i ndonjë personi ose grupit të njerëzve, gjegjësisht me të cilin arrihet efekt i tillë, e posaçërisht kur sjellja e tillë shkakton

frigë ose krijon armiqësi, përlulje, frigësim, degradim ose mjedis ofendues”¹

Për shembull, kur mësimdhënësi bën “llafe” me nxënësen duke përdorur aluzione seksuale, inkurajon shokët nga klasa e saj të komentojnë pamjen e saj, etj. Shembull i shqetësimit seksual verbal janë llafet me konotacion seksual, duke i dërguar komplimente të tepërta, telefonata të tepërta, mesazhe dhe e-mail të papërshtatshme, si dhe shqetësime të këtij llojit në rrjetet shoqërore. Shpesh shqetësimi seksual tek vajzat karakterizohet si “llafe dhe pjesë e rritjes së meshkujve”. Promovimi dhe përhapja e sjelljes së këtillë është e gabueshme dhe ajo bjen deri tek stereotipizimi i roleve gjinore, e pasoja përfundimtare është edhe normalizimi i dhunës në lidhjet, por edhe qëndrimi i shpesht tek të rinjtë që të fajësojnë viktimen për shqetësim seksualë, për shkak të sjelljes provokative të saj. Thjesht, gjithçka që rrisë, nxënësit apo nxënëses, i pëngon është shqetësimi, pavarësisht a ka apo jo konotacion seksual. Roli i arsimit dhe shkollës është që të punojë në përhapjen e mirëkuptimit seksual tek të rinjtë në të gjitha aspektet, në mënyrë që në këtë segment të jetes të kultivojnë dhe përhapin stilet e shëndoshta të sjelljes.

Diskriminimi është posaçërisht i rëndë nëse ka të bëjë me **diskriminimin e shumëfishtë ose të përsëritur**. Diskriminimi i shumëfishtë nënkupton diskriminimin e një personi për më shumë veçori personale. Për shembull: ndonjë nxënëse mund të jetë viktimë e diskriminimit në arsim për atë se është femer dhe Romë. Ky lloj diskriminimit është rreptësisht i ndaluar për shumë pasoja që ka për viktimen. Gjithashtu, diskriminimi mund të përsëritet dhe kështu të shkelen rëndë të drejtat e njeriut. Për shembull: nxënësit Romë disa herë i është refuzuar rregjistrimi në shkollën e mesme, sepse i është sygjeruar që të rregjistrohet në një shkollë tjetër të qytetit në të cilën shumica janë Romë.

Gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes është gjuhë publike, e cila emitohet në hapësirë publike, ndërmjet tjerash edhe përmes mediave, internetit ose rrjetëve sociale. Kjo lloj gjuhe ka për qëllim që të sulmojë, zhvlerësojë, heq një të drejtë, frikësojë apo nxit në urrejtje dhe mostolerancë ndaj një personi tjetër apo grupi njerëzish të cilët janë të njohur për nga karakteristikat e mbrojtura si ngjyra e lëkures, gjinija, gjuha, gjendja materijale, pozicioni shoqërorë, arsimit, gjendjes shëndetësore, invaliditetit, etj.

Ligji për ndalimin e diskriminimit e definon kështu: “gjuha e urrejtjes është çdo formë e shprehjes së idesë, qëndrimit, informacionit dhe mendimit i cili përhap, nxit apo arsyeton diskriminimin, urrejtjen apo dhunën ndaj individit apo grupit të njerëzve për shkak të veçorive të tyre personale, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të urrejtjes të bazuara në jotolerancë, përfshirë edhe jotolerancën në formë të nacionalizmit, diskriminimit dhe

¹ Ligji për ndalimin e diskriminimit, Gazeta zyrtare Mali i Zi, nr. 046/10, 040/11, 018/14, 042/17

armiqësisë ndaj pakicave"²

Gjuha e urrejtjes shpesh definohehet si shprehje e cila është e pakëndshme, ofenduese, frikësuese, shqetësuese e cila nxit dhunën, urrejtjen ose diskriminimin. **Liria e shprehjes përfundon aty ku fillon përqeshja, gjuha ofenduese e cila thërret në dhunë dhe diskriminim.** Do të thotë se liria e shprehjes si një ndër të drejtat kyçe të njeriut nuk është absolute, faktikisht është e kufizuar, sepse nuk guxon të ndërhyjë dhe rrezikoj të drejtat dhe liritë e njerëzve tjer.

Gjuha e urrejtjes manifestohet në arsim dhe ndodhë ndërmjet akterëve të ndryshëm në procesin arsimorë. Nëse dikush shkruan mesazhe diskriminuese në muret e shkollës, klases apo në afërsi të shkollës, thërret në urrejtje dhe dhunë ndaj njerit prej aktorëve të procesit arsimorë për arsye të karakteristikave apo përkatësisë, atëherë kemi të bëjmë me gjuhën e urrejtjes. Per shembull: në murin e shkollës është shkruar grafiti "Teli, thika, Srebrenica!"; "Magjypve thika ne fyt!" ose "Vraj, prej, që pederi mos të ekzistojë!".

Gjuha e urrejtjes ndonjëherë mund të përhapet edhe përmes gazetave të shkollës, rrjeteve shoqërore dhe web faqes së shkollës dhe përmbajtjeve tjera të cilat krijohen, ose përdoren në procesin arsimorë, si dhe përmes bashkimëve të ndryshme, ngjarjeve në shkollë ose në organizimin e shkollës. Për shembull: në gazetën e shkollës është publikuar teksti i cili përmban intervistën me muzikantin që promovon homofobinë. Gjuha e urrejtjes përhapet edhe kur pjesmarrësit e procesit arsimorë publikisht i shprehin idetë, informatat dhe mendimet me të cilat thirret në trajtim jo të barabartë, urrejtje dhe dhunë ndaj personit apo grupi të njerëzve për shkak të veçorive të tyre personale. Ose, kur profesoresha e shkollës publikon në faqen e saj të Fejsbukut statusin në të cilin shpreh se personat LGBT duhet të heshten në çdo mënyrë sepse përhapin sëmundje.

Çfarëdo thirrje në urrejtje ose në nxitimin, përhapjen dhe arsyetimin e dhunës ndaj personit

² Ibid.



apo grupit të njerëzve për orientimin e tyre seksual apo cilen do veçori personale tjetër, është një hap më afër ndermarrjes së dhunës ndaj këtyre personave dhe shkaktimit të dëmit të paparë për krejt shoqërinë. Shembull tipik i gjuhës së urrejtjes të cilen mund ta ndëgjojmë ose lexojmë në rrjetet sociale dhe në komente në portale është: *"Hitleri ka pas zgjedhje adekvate për Rom, ashtu duhet me ta, në dhomë me gaz dhe problemi rregullohet!"*, ose komenti në paradën e krenarisë të LGBT personave: *"Na duhet ti ndalojmë, është sëmundje dhe duhet të shërohet...njerëzit e këtillë duhet të mbyllen!"*


Gjuha e urrejtjes shpesh është e drejtuar në statusin social dhe ekonomik të të rinjëve apo në pamjen e tyre fizike. Një shembull i tillë mund të jetë krijimi i faqes në rrjetet sociale me emrin *"Njerëzit e trashë janë të neveritshëm"*, në të cilën nxënësit vendosin fotografi dhe shkruajnë komente për shokët e tyre që vlerësojnë se janë të trashë.

Karakteristika e gjuhës së urrejtjes është tendenca që të krijojë armiqësi ndaj një personi të caktuar apo grupi, e shpesh ka të bëjë edhe me dënimin e mjedisit ndaj një personi ose grupi për shkak të ndonjë veçorije personale. Me gjuhë të urrejtjes nxitet ndjenja e pasigurisë dhe frigës tek një person i caktuar përmes thirrjes në shkaktimin e dhimbjeve fizike dhe psikike duke dërguar kërcënime, nxitur dhe shkaktuar dhunë. Përmes gjuhës së urrejtjes provohet që të krijohet ndjenja tek një numër i madh i qytetarëve se ajo sjellje ndaj një personi/grupi është e dëshirueshme dhe e arsyetueshme dhe ekziston tendenca e personit i cili inspiron gjuhen e urrejtjes që marrëdhënja e tillë të normalizohet.

Si edhe tek diskriminimet tjera është e rëndësishme të reagohet, ta lajmëroni rastin profesorit, udhëheqësisë së shkollës, si dhe inspektionit që gjuha e urrejtjes të eliminohet, e ata të cilët promovojnë gjuhen e urrejtjes të sanksionohen në menyrë adekvate.

Segregacioni

Segregacioni nënkupton ndarjen e një grupi njerëzish që ka veçori të njëjta nga shumica e njerëzve në sferat e caktuara të jetes, por edhe në arsim. Segregacioni është formë e rëndë e diskriminimit dhe si e tillë është rreptësisht e sanksionuar me ligj. Shembull i segregacionit janë paralelet e posaçme për Romët, ose për nxënësit me nevoja të posaçme në arsim. Në Bosnjë dhe Hercegovinë një kohë të gjatë ballafaqohen me ndarjen e nxënësve në baza etnike dhe religjioze, në të ashtuquajtura shkolla të ndara nën një çati, ku në të njëjtën hapësirë mësojnë të rinjtë nga grupe etnike të ndryshme, të ndarë nga njëri tjetri.



Diskriminimi në arsim

Arsimi është e drejtë themelore njerëzore e cila është e domosdoshme për arritjen e të gjitha të drejtave (UNESCO, 2010). Me arsimim individët dhe grupet shoqërore dalin nga varfëria dhe izolimi, bëhen anëtarë të barabartë të jetës shoqërore dhe vendimmarrës në shoqëri dhe për këtë arsimimi është shumë i rëndësishëm. Barazia në arsim nënkupton barazinë në shoqëri, përkatësisht mundësitë e njëjta që të gjithë individët të zhvillojnë aftësitë e veta, arisin dije dhe të marrin një pozicion në shoqëri në bazë të kapaciteteve dhe pa diskriminim. Nëse janë të diskriminuar në arsim disa grupe shoqërore, apo individë, për veçoritë e veta personale, do të thotë se nuk do ta arrijnë barazinë në punësim, në të mirat dhe në shërbim, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore, etj.



Secili prej nesh ka të drejtë në qasjen e njëjtë në arsim. Këtë të drejtë në qasjen e barabartë në arsim dhe mundësinë që të shkollohemi na e garanton ligji për arsim³, por edhe Kushtetuta si akti juridik më i lartë shtetërorë i cili na garanton qasje të njëjtë dhe barabartë në arsim për të gjithë. Kur flasim për të drejtat e nxënësve, Ligji u garanton nxënësve të drejtën e mbrojtjes nga të gjitha llojet e dhunës, diskriminimit, abuzimit dhe pakujdesisë në shkollë, që më afër përcaktohet me statutin e shkollës. E rëndësishme është edhe obligimi i nxënësit që të respektojë personalitetin e shokëve të klases dhe shkollës, si dhe personalitetin e profesorit dhe me të të bashkëpunojë duke përcjell rregullisht mësimin, ti përmbahet diciplinës gjatë mësimin dhe rregullave tjera të rëndësishme në shkollë.

Diskriminim në arsim ndodh atëherë kur një individ, shoku i klasës, mësimdhënësi, dikush nga udhëheqësija e shkollës, kushdo nga procesi arsimorë me trajtim, prurjen e vendimeve, rregullave apo ligjeve në rast të institucionit kompetent, vështirëson apo pamundëson/shkelë arritjen e të drejtës në arsim vetëm për shkak të veçorive personale.

Diskriminimi në arsim mund të paraqitet në çdo faze dhe aspekt të procesit arsimorë, që nga rregjistrimi në shkollë, deri tek zbatimi i masave disiplinore dhe edukative, deri tek vlerësimi dhe promovimi i pabarazisë dhe diskriminimit përmes përmbajtjeve të arsimin, përmbajtjeve të librave të cilët promovojnë homofobinë apo distancën etnike.

Të diskriminuar në arsim mund të jeni edhe atëherë kur lajmëroni dhe reagoni në diskriminim, dhe për këtë paraqitje ju diskriminojnë moshatarët e juaj dhe shokët e shkollës apo mësimdhënësit. **Askush nuk guxon të jetë i diskriminuar nëse ka lajmëruar diskriminimin në të cilin është dëshmitar.** Ekziston edhe ky nen në ligj, i cili shpreh qartë ndalimin e viktimizimit. Nëse reagoni për shkak që mësimdhënësi ka vlerësuar arritjet e nxënësve në mënyrë të pabarabartë, ka dhënë notat më të mira nxënësve të cilët nuk janë Romë, apo fëmijëve të njerëzve me ndikim nga mjedisi juaj, ai në asnjë mënyrë nuk guxon t'ju dënoj edhe më shumë për këtë arsye dhe të ndërmar çfar do hakmarrje ndaj juve.

³ Ligji i përgjithshëm për arsim dhe edukim, normat antidiskriminuese dhe principet nga ky ligj janë të inkuorporuara në të gjitha ligjet të cilat rregullojnë arsimin në çdo nivel

Si të mbroheni nga diskriminimi?

Me rëndësi është të kuptojmë çka është diskriminimi, që mund ta njohim, që mund të dyshojmë se është duke ndodhur dhe ta lajmërojmë, të flasim për të me ndonjë person nga shkolla ose ti drejtohem institucionit Mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe lirive apo ndonjë organizate joqeveritare në mënyrë që të fitojmë informacione të plota. Pra, të ndërmarrim gjithçka që të parandalojmë ndodhjen e pasojave negative të diskriminimit, si neve personalisht, apo dikuj nga shokëve tanë nga shkolla, ose kujdo nga shoqëria.

Me rëndësi është ta njohim kohësisht dhe të reagojmë në mënyrë adekvate në diskriminim, sepse ai mund të na çojë në ankth, depresion, bile edhe deri tek vetëlendimi i viktimës. Me rëndësi është të mbani mend se injorimi dhe minimizimi i diskriminimit, duke ja lënë rinisë apo fazes së rritjes, dërgon mesazh të aprovimit dhe krijon mjedis armiqësor. Pra, paraqitjen e shkeljeve të drejtave të njeriut dhe diskriminimit edhe nëse ato janë të dyshshme kurrë nuk duhet relativizuar dhe anashkaluar.

Nëse keni ndjenjë dhe mendoni se ndonjë e drejtë e juve është shkelur flisni dhe drejtohuni kujdestarit tuaj ose ndonjë mësimdhënësi tjetër në të cilin keni besim. Flisni për rastin dhe kerkoni këshilla. Bëjeni këtë gjithmonë kur keni vërejtje në organizimin e mësimdhënies, cilësinë, objektivitetin e vlerësimit, zbatimin e masave disiplinore, sigurisë në shkollë, etj. Përveç mësimdhënësit dhe kujdestarit të klases përkrahjen mundeni, dhe është e dëshirueshme, që ta kërkonin nga shërbimet psikologjike dhe pedagogjike në shkollë, drejtorit, këshillave të klases dhe shkollës të cilët ekzistojnë, këshillit të prindërve, etj. Nëse problemi nuk mund të zgjidhet brenda në shkollë, ose ekziston pakënaqësia në mënyrën se si zgjidhet, mundeni të kërkonin mbrojtje shtesë nga **Inspekcioni i Ministrisë së arsimit**, por edhe shërbimëve dhe organizatave jashtë shkolle, siç është **Mbrojtësi i të drejtave dhe lirive të njeriut** i cili është institucion kyç në mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi, ose ndonjë organizatë joqeveritare e cila merret me të drejtat e njeriut dhe mund të ju këshillojë si është më mirë të veprohet në raste konkrete. Në rastet më të vështira, dhe për shkak të reagimit të papërshtatshëm të shkollës dhe institucioneve tjera arsimore kompetente, përkrahjen mund ta kërkonin edhe në gjyq.

Hapi i parë në rastin e diskriminimit është diskutimi dhe përpjekja që të zgjidhet situata përmes dialogut dhe ndërmjetësimit midis pjesëmarrësve në procesin arsimor. Funkcioni i të punësuarëve në institucion i obligon që të bisedojnë me pjesëmarrësit e diskriminimit për shkaqet dhe detajet tjera, dhe të provojnë që të rregullojnë situatën që mos të marrë proporcione të gjëra dhe pasoja të këqija. Nëse, megjithatë, bëhet fjalë për raste të rënda atëherë ndaj atij i cili diskriminon mund të ndermerren masa edukative, ose proces disiplinorë i cili mund të rezultojë në rastet më të rënda, me largim të nxënësit nga shkolla, ose shkarkimin nëse është në pyetje diskriminimi të cilin e ka bërë mësimdhënësi ose ndonjë person tjetër i punësuar në shkollë. Në çdo veprim të cilin e bëni me qëllim që të luftoni diskriminimin në shkollë, në çdo padi dhe reagim nga ana e udhëheqësisë së shkollës, organit dhe trupit brenda institucionit të shkollës në zgjidhjen e problemit, është me rëndësi që të dini se ekziston edhe mundësia

e ankeses Inspektionit të arsimit apo Ministrisë së arsimit. Inspektioni dhe Ministria e arsimit kujdesohen që procesi i mësimi të zhvillohet në përputhshmëri me ligj, dhe kjo përfshin edhe ndalimin dhe mbrojtjen e nxënësve nga çdo lloj shkelje të të drejtave në çdo aspekt të arsimit.

Ekziston një seri e tërë dokumentesh shtetërore, nga Kushtetuta, përmes ligjeve arsimore deri tek Ligji për ndalimin e diskriminimit, i cili ndalon dallimin e pajustificuar të pjesëmarrësve në arsim.

Përkrahjen gjithmonë mund ta kërkontë edhe tek **organizatat joqeveritare** të cilat merren me parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Në mesin e tyre ekziston një numër i madh i organizatave që japin këshilla falas dhe përkrahje juridike në mënyrë që do ju udhëzojnë për procedurat adekvate dhe adresat ku ju mund të drejtoheni jashtë sistemit arsimorë. Qendra për edukim qytetarë (QEQ) përmes **RED line linjës telefonike për përkrahjen e të rinjve të cilët ballafaqohen me diskriminim në arsim** u ofron përkrahje dhe udhëzime për procesim të mëtejshëm të gjithëve të cilët dyshojnë se janë viktime të diskriminimit ose ndonjë shkelje tjetër e drejtave të njeriut. Të gjithë të interesuarit mund të konsultohen me ekipin e QEQ-it në numrin e celularit 020-228-479, 067 289 336 ose nëpërmjet rrjetëve shoqërore.



Mbrojtësi i drejtave dhe lirive të njeriut

Nëse mendon se e drejta jote është rrezikuar ose je i ekspozuar diskriminimit në shkollë nga cilido anëtar në procesin arsimorë (udhëheqësia e shkollës, mësimmshënësi, inspekcioni, Ministria) mund ti drejtoheni edhe Mbrojtësit të drejtave dhe lirive njerëzore.

Procedura e ankesave para Mbrojtësit është falas dhe konfidenciale. Në ankesë është e nevojshme të cekni të gjitha faktet që kanë të bëjnë me rastin dhe informacionet e kontaktit, dokumentacionin e caktuar nëse ekziston, etj. Pas dorëzimit të ankesës Mbrojtësi fillon procedurën dhe fton shkollën ose institucionin arsimorë që të dëshmojë për rast dhe çdo informacion relevant në bazë të cilave vërtetohet si të veprohet në rastin konkret dhe a ekziston shkelje e drejtave, apo diskriminim. Nëse vërtetohet se diskriminimi është kryer, Mbrojtësi do të japë rekomandim që të korigjohet shkelja e drejtave ose diskriminimi, ose propozohet hapja e procedurës pranë institucioneve me kompetenca për mbrojtjen e të drejtave. Mbrojtësi mund të urdhërojë institucionin arsimorë të fillojë procesin dicitplinorë kundra personit i cili ka bërë diskriminimin, ose paraqitjen e një kërkesë për fillimin e procesit penal.

Në faqen e institucionit mund të fitoni të gjitha informacionet se ku dhe kur pranohen palët, në mënyrë që rasti të prezantohet në komunikim të drejtëpërdrejtë. Ekziston edhe forma e ankesës dhe mundësia që të dërgohen në formën elektronike, dhe atëherë nëse është e nevojshme dikush nga institucioni do të kërkojë informacione plotësuese ose takim të drejtëpërdrejtë. Më shumë informacione për institucionin e Mbrojtësit dhe procesit të adresimit mund ti fitoni në ueb prezantimin <http://www.ombudsman.co.me> ose përmes celularit 020 225 395.

Adresimi në gjyq

Në rast të diskriminimit mbrojtja mund të arrihet edhe në gjyq. Procesi i mbrojtjes nga diskriminimi para gjyqit është urgjent dhe realizohet me padi pranë gjyqit themelorë në komunë në të cilën jetoni dhe shkoni në shkollë. Me padinë për diskriminim thjesht mund të kërkohe: që diskriminimi i cili ndodhë të ndalohet, të ndalohet vazhdimi i diskriminimit, të eliminohen pasojat e diskriminimit dhe të kërkohe kompensimi për dëmin jomonetar.





Kurrë mos duro diskriminimin ose ndonjë shkelje tjetër të drejtave të njeriut, përfshirë edhe dhunen!

Për çdo situatë ekziston zgjidhja, sepse askush nuk guxon të diskriminoj dhe ti kufizojë të drejtat. Çdo pjesmarrës në procesin arsimorë është aty që të ofrojë përkrahje në aspektin e mbrojtjes nga diskriminimi. Siç e mbron vehten nga diskriminimi, gjithashtu është e rëndësishme të reagosh në çdo diskriminim që dëshmon, ti ofrosh përkrahje viktimës dhe kërkosh ndihmë!



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



Tel: +382 20 228 479
Fax: +382 20 228 499



info@cgo-cce.org
www.cgo-cce.org



Bulevar Svetog Petra Cetinjskog 96, III/6
81000, Podgorica, Crna Gora